



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:073998

Datë: 18.07.2022

Numri i dokumentit: 03239555

P. nr.159/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci , në çështjen penale kundër të akuzuarave F.M. dhe M.K. , që te dyja nga Gj., për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë në bashkëkryerje e në vazhdimësi nga neni 315 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë–Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.537/22 dt.27.04.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë 12.07.2022 , në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarave , me datë 14.07.2022 mori dhe publikisht shpalli, këtë :

A K T G J Y K I M

E akuzuara **F.M.** , nga Gj. ,Rr., , e lindur me... ,e bija e A. dhe e nënës Z. e gjinisë V. , ka te kryer shkollën e mesme , e pa punë , e gjendjes se dobët ekonomike , shqiptare , shtetase e R. Kosovës , e pa martuar , me ID...

E akuzuara **M.K.** , nga Gj.,Rr.,, e lindur me... ,e bija e B. dhe e nënës L. e gjinisë R. , ka te kryer shkollën e mesme , e pa punë , e gjendjes se dobët ekonomike , shqiptare , shtetase e R. Kosovës , e pa martuar , me ID...

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-nga data **15.03.2022** e në vazhdimësi deri më datë **20.03.2022** në Qendrën tregtare N. në Gj., me qëllim të përvetësimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme dhe në bashkëveprim me njëra tjetrën kanë marr sendet e luajtshme pronë e të dëmtuarës L., në atë mënyrë që të pandehurat F.M. dhe M.K. shkojnë në dyqanin e rrobave L.. pesë (5) ditë me radhë dhe aty marrin disa pale trenerka, duksa sportiv dhe çanta të krahut dhe të njëjtat fillimisht i dërgojnë në dhomën e zhveshjeve e më pas përmes një palë gërshtëre i'u heqin alarmet dhe arrin ti marrin me vete pa i vërejtur askush disa ditë me radhë deri në ditën kritike me dt.20.03.2022 kur edhe janë zënë në flagrancë, me ç 'rast të dëmtuarës i kanë shkaktuar dëm material në vlerë rreth 200 Euro.

- me çka kanë kryer veprën penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje e në vazhdimësi nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31-77 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39,43, 46, 47, 48, 49 par.5,69, 70, 71, 72 të KPRK-së, dhe nenit 315 par.1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarave, iu shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarës **F.M.** me Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj**, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200(dyqind) euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të akuzuarës **F.M.** me Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muaj**, si dhe dënim me gjobë në shumë prej **200(dyqind) euro**, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

E dëmtuara L.. “ në Gj. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil .

Detyrohen të akuzuarat që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguajnë shpenzimet në shumë prej nga **30,00 € si** dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **20.00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të marr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.537/22 dt.27.04.2022 ,ka akuzuar të akuzuarat F.M. dhe M.K. nga Gj. bashkëkryerje e në vazhdimësi nga neni 315 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së ,duke propozuar që të akuzuarat të shpallet fajtoresh dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 12.07.2022 , përfaqësuesi i Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Prokurori i Shtetit Anton Hasanaj , lexoi aktakuzën PP/II.nr.537/22 dt.27.04.2022 me ç ‘rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës por beje plotësimin e kualifikimit juridik ashtu që duhet të jete me çka kanë kryer veprën pe ale vjedhje e rende ne bashkëkryerje e e në vazhdimësi nga nenin 315 par. 1 nën par. 1.1 -31-77 të KPRK-ës. .

E akuzuara F.M. ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës duke i ditur edhe me pare pasojat dhe favore të juridike të pranimit të fajësisë, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprat e kryera e të cilat i kam kryer për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike edhe pse të gjitha gjësendet janë kthyer të dëmtuarës .Andaj i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , gjendjen e dobët ekonomike ,premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme ,kërkim falje nga e dëmtuara për veprimet e mijë , faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

E akuzuara M.K. , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar ,lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktakuzës duke i ditur edhe me pare pasojat dhe favore të juridike të pranimit të fajësisë, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprat e kryera e të cilat i kam kryer për

shkak te gjendjes se rende ekonomike edhe pse te gjitha gjësendet janë kthyer te dëmtuarës .Andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë , gjendjen e dobët ekonomike ,premtimin se ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme ,kërkim falje nga e dëmtuara për veprimet e mija , faktin se me parë nuk kam ra ndesh me lignin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë nga të akuzuarit Prokurori i shtetit Anton Hasanaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe të njëjtat janë të vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimit te fajësisë te sqaruara edhe nga ana e gjykatës , dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat qe ndodhen ne shkresat e lendes, andaj gjykatës i propozoi qe te beje pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve si shprehjeje e vullnetit te lirë dhe te akuzuarve te ju shqiptohet një dënim meritor konform ligjit ,duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese ,pranimin e fajësisë gjatë gjithë fazave te procedurës ,pendimin për veprën e kryer ,kërkim falje , sjellja e tyre pas kryerjes se veprës si dhe faktin se te njëjtat për herë te parë paraqiten para gjykatës për një vepër te tillë penale, si dhe te obligohen ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarat F.M. si dhe M.K. : **-nga data 15.03.2022 e në vazhdimësi deri më datë 20.03.2022 në Qendrën tregtare N. në Gjakovë,** me qëllim të përvetësimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme dhe në bashkëveprim me njëra tjetrën kanë marr sendet e luajshme pronë e të dëmtuarës L..., në atë mënyrë që të pandehurat F.M. dhe M.K. shkojnë në dyqanin e rrobave L.. pesë (5) ditë me radhë dhe aty marrin disa pale trenerka, duksa sportiv dhe çanta të krahut dhe të njëjtat fillimisht i dërgojnë në dhomën e zhveshjeve e më pas përmes një palë gërshtëre i'u heqin alarmet dhe arrin ti marrin me vete pa i vërejtur askush disa ditë me radhë deri në ditën kritike me dt.20.03.2022 kur edhe janë zënë në flagrancë, me ç 'rast të dëmtuarës i kanë shkaktuar dëm material në vlerë rreth 200 Euro.-**me çka kanë kryer veprën penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje e ne vazhdimësi nga neni 315 par.1 nënpar.1.1 lidhur me nenin 31-77 të KPRK-së.**

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarat të cilat në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarat është bërë në pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se të akuzuarat e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarat, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin kundër të akuzuarave dhe llojit të tij, Gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të aktgjykimit , ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarave se të akuzuarat janë të moshës së re, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga të akuzuarat në çdo fazë të procedurës, sjellja e tyre korrekte në gjykim , pendimin e tyre të thellë , premtimin e tyre se nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme , kërkim falja publike në gjykatë nga e dëmtuara , gjendjen e dobët ekonomike, gjësendet e vjedhura i janë kthyer te dëmtuarës ,e të cilat rrethana ndikuan që gjykata duke pasur parasysh edhe mënyrë dhe rrethanat e kryerjes së kësaj vepre penale, , ka zbatuar dispozitat e zbutjes se dënimit bazuar në nenin 72 par.1 nënpar.1.3 te KPRK-së, dhe të akuzuarave iu i ka shqiptuar dënimin nën minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga **14(katërmëdhjetë) muaj si dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 200(dyqind**

) **euro** , të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse të akuzuarat brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale .

i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të akuzuarat brenda kohës së verifikimit në afatin **prej 2(dy) viteve** , nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale ,me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarat dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarave nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike , është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës, pasi qe gjykata gjate shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundur qe ta saktësojë lartësinë e dëmit që të akuzuarat iu kanë shkaktuar të dëmtuarës pasi qe nuk ka asnjë ekspertize apo konstatim për lartësinë e dëmit të shkaktuar .

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej nga 20.00€ , është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2 .6 te KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej nga 30.00 € , është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.159/22 më datë 14.07.2022**

**Zyrtarja ligjore,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.